VENDIM
Nr. 94/2017

PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS ORGANIZATIVE, ORGANIKËS DHE KLASIFIKIMIT TË PAGAVE TË PERSONELIT TË KOMISIONERËVE PUBLIKË

Në mbështetje të nenit 78 dhe nenit C të Kushtetutës, si dhe të neneve 18, pika 1, dhe 29 të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Komisionerëve Publikë,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Komisionerëve Publikë.

II. Organika dhe klasifikimi i pagave të personelit të Komisionerëve Publikë është sipas lidhjes nr. 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

III. Struktura organizative e personelit të Komisionerëve Publikë është sipas lidhjes nr. 2 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 29.9.2017

Lidhja nr. 1

ORGANIKA DHE KLASIFIKIMI I PAGAVE TË KOMISIONERËVE PUBLIKË

Funksioni organik	**Klasifikimi i pagës**	**Numri**
I. KOMISIONERI PUBLIK		**(4)**
Komisionerë Publikë	G3*	2
Sekretarë	Sekretar në kabinetin e ministrit**	2
II. KANCELAR	I-b	**(1)**
III. NJËSIA E SHËRBIMIT LIGJOR		**(6)**
Këshilltarë juristë	80% e pagës G3*	4
Këshilltarë ekonomistë	80% e pagës G3*	2
IV. DREJTORIA E MENAXHIMIT TË ÇËSHTJEVE DHE MARRËDHËNIEVE ME MEDIAN DHE PUBLIKUN		**(7)**
Drejtor	II-b	1
Specialist sekretarie	IV-a	2
Specialist redaktor gjuhësor	IV-b	1
Përkthyes	II-b	1
Koordinator për median dhe marrëdhëniet me jashtë	III-a	1

Specialist pritje me popullin	IV-b	1
V. DREJTORIA EKONOMIKE DHE E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE		**(8)**
Drejtor	II-b	1
Specialist financë/buxhet	III-b	1
Specialist i burimeve njerëzore	III-b	1
Specialist IT	III-b	1
Specialist protokoll/arkiv	IV-b	1
Magazinier	VII	1
Punonjës pastrimi	III	1
Shofer	V	1
Gjithsej		**26**

Shënim:
** Sipas ligjit "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".*
*** Kategoria e pagës për pozicionin e sekretarit është sipas VKM-së nr. 187/2017.*

Lidhja nr. 2

STRUKTURA ORGANIZATIVE E KOMISIONEREVE PUBLIKE